



2025 GUSHT

Mbrojtja në një muaj





DEKOROHEN EFEKTIVËT QË LUFTUAN ZJARRET

Në një ceremoni të zhvilluar në Tiranë, kryeministri i Shqipërisë dekoroi 24 efektivë të Forcave të Armatosura, Policisë së Shtetit, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe shërbimeve zjarrfikëse, të cilët u dalluan në operacionet e fundit për shuarjen e zjarreve në disa zona të vendit. Në fjalën e tij, kryeministri theksoi se këto dekorime janë një shenjë mirënjohjeje për të gjithë ata që luftuan me flakët, duke vënë në rrezik jetën e tyre për të mbrojtur qytetarët.

★★★★★



MBI 3000 EFEKTIVË TË ANGAZHUAR NË SHUARJEN E ZJARREVE

Gjatë muajit gusht, në operacionet për shuarjen e zjarreve në të gjithë vendin u angazhuan 3029 efektivë të Forcave të Armatosura dhe 269 mjete. Gjithashtu, 2 helikopterë të Forcave të Armatosura u përdorën në operacione ajrore në mbështetje të strukturave vendore. Falë përfshirjes së Shqipërisë në Mekanizmin Evropian të Mbrojtjes Civile (ERCC), vendit iu ofrua edhe mbështetje ajrore nga disa shtete partnere, duke forcuar ndjeshëm kapacitetet për menaxhimin e situatës. Aktualisht, situata paraqitet nën kontroll dhe monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga strukturat përkatëse.

★★★★★



PËRKUJTOHET KRIJIMI I KOMANDËS SË FORCËS TOKËSORE

Në një ceremoni të veçantë të zhvilluar në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore në Zall-Herr, u përkujtua krijimi i kësaj strukture të rëndësishme të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në fjalën e tij, ministri Vengu vlerësoi rëndësinë që ka pasur themelimi i Komandës së Forcës Tokësore si një akt i domosdoshëm për ringritjen e ushtrisë shqiptare dhe konsolidimin e shtetit pas një periudhe sfiduese për vendin.

★★★★★

mod.gov.al



EOD VIJON PASTRIMIN E TERRENEVE NGA MUNICIONET E PAPLASURA

Kompania EOD po vazhdon me intensitet operacionet e pastrimit të sipërfaqeve nga municionet e paplasura në bashkitë Vlorë, Kolonjë dhe Kurbin. Operatorët e EOD, me profesionalizëm dhe përkushtim, kanë përfunduar me sukses disa detyra të rëndësishme, duke kontribuar në rritjen e sigurisë për komunitetin dhe zhvillimin e zonave të prekura.

★★★★★

mod.gov.al

MM




ZGJEROHEN HAPËSIRAT E KOMPLEKSIT MUZEAL TË FA

Kompleksi Muzeal i Forcave të Armatosura në Bërzhitë do të zgjerohet me hapësira moderne që lidhin historinë me komunitetin, duke sjellë një rrëfim arkitektonik dhe ambiente funksionale për aktivitetet e përditshme të FA dhe industrisë së mbrojtjes.

★★★★★

mod.gov.al

MM





“LISSUS” SHPËTON 25 JETË NË EGJE

Anija “LISSUS” P-133, me mision në detin Egje, shpëtoi 25 emigrantë (afganë dhe sirianë), përfshirë gra dhe fëmijë, në bashkëpunim me Rojen Bregdetare Turke. Operacioni u krye me sukses gjatë një patrullimi rutinë, duke dëshmuar angazhimin e Forcës Detare për sigurinë në det dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

★★★★★

mod.gov.al

MM



STËRVITJE E PËRBASHKËT SHQIPËRI-KOSOVË

Efektivët e Qendrës së Zhytjes së Forcës Detare të Shqipërisë zhvilluan në Pashaliman një stërvitje të përbashkët me Forcën e Sigurisë së Kosovës, duke forcuar ndërveprimin dhe kapacitetet për misionet nënujore.

★★★★★

mod.gov.al

MM





SHQIPËRIA, E FTUARA E NDERIT NË “PÉRIGORD NOIR”

Në edicionin e 43-të të Festivalit Ndërkombëtar të Muzikës Klasike “Périgord Noir” në Francë, Shqipëria ishte vendi i ftuar i nderit. Kuarteti TOGHA i Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura dhe mezzosopranoja kosovare Flaka Goranci sollën një program tërësisht shqiptar, me melodi nga të gjitha trevat. Performanca u prit me entuziazëm.

★★★★★

mod.gov.al

MM



FORCA AJRORE DREJT MODERNIZIMIT

Në Bazën Ajrore të Farkës vijon Rivlerësimi Strategjik i Mbrojtjes, me fokus modernizimin e flotës, infrastrukturës dhe trajnimin e burimeve njerëzore, sipas objektivave të Samitit të Hagës. Investimet përfshijnë pajisje dhe armatim të avancuar, rikthimin e Shkollës së Aviacionit në Vlorë dhe rritjen e sigurisë në bazat ajrore të vendit.

★★★★★

mod.gov.al

MM



FORCA DETARE SHQIPTARE NË MISSIONIN E NATO-S NË EGJE

Kontingjenti i IX i Forcës Detare u nis me anijen “Lissus” drejt Detit Egje për operacionin “Sea Guardian” të NATO-s. Efektivët shqiptarë do të kontribuojnë në sigurinë detare dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, duke dëshmuar gatishmëri dhe profesionalizëm

★★★★★

mod.gov.al

MM